

TERMA REFERENCE

**PER HARTIMIN E PROJEKT-PREVENTIVIT TE ZBATIMIT TE OBJEKTIT  
REHABILITIMI I PERROIT TE GLINES**

**BASHKIA VAU DEJES**

## **DETYRE PROJEKTIMI DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE**

Detyra e projektimit përmban studimin dhe mbrojtjen nga gerryerjet, me qëllim marrjen e masave për eliminimin e permbytjeve në sezonin e dimrit për objektin:

### **Rehabilitimi i Perroit të Glines**

#### **I. PERSHKRIMI I SHKURTER I GJENDJES**

##### **Rehabilitimi i Perroit të Glines**

Vendndodhja: Bashkia Vau Dejes

Perroi i Glines është një nga veprat më të rëndësishme të infrastruktures së kullimit për Bashkinë Vau Dejes. Ka një gjatësi rreth 4.9 km nga formimi të Qafa e Laçit deri në derdhje në Lumin Gjader.

Ka një pellg shimbledhës prej 550 ha.

Para viteve 1990 në aksin e këtij perroi janë ndërtuar dy prita malore për të normalizuar rrjedhjen e ujit dhe për pasojë dhe prurjen e materialit të ngurtë që gerryhet nga shpatet e zhveshura të kodrave përreth.

Gjendja e shtratit të këtij perroi është mjaft problematike. Në vitet e vazhduara të demtoje brigjet në të dy anët e rrjedhjes dhe për pasojë ka demtuar veprat e ndërtuara në infrastrukturen rrugore. Për pasojë është kthyer në një rrezik të madh jo vetëm për këto vepra por dhe për popullsinë dhe banesat e tyre.

Aktualisht ka demtuar priten e dytë malore në pusin e shuarjes dhe muret e saj.

Ka demtuar murin rrethues të varrezave.

Ka demtuar uren në rrugën që të çon në këto varreza.

Ka demtuar shpatin në anën e majtë të rrjedhës në hyrje të ures egzistuese të rruges që vjen nga Nenshati.

Ka demtuar shpatin në anën e djathtë të rrjedhës në hyrje të ures egzistuese "Beli" në qendër të qytetit.

Ka demtuar veprën që ndërpret Unazën e qytetit dhe rrugën pasi ka kapërcyer mbi të.

Sa më sipër kerkohet të hartohet projekt zbatimi për Rehabilitimin e Perroit të Glines duke patur parasysh sa më poshtë:

1.- Te parashikohen punime per rehabilitimin e shtratit te ketij perroi duke filluar nga prita e dyte malore e deri ne derdhje ne lumin Gjader me gjatesi rreth 2.5 km.

2.- Te parashikohen punime per rikonstrukcionin e prites se dyte malore

3.- Te parashikohen punime per rikonstrukcionin murit rrethues te varrezave

4.- Të parashikohet të rehabilitohen urat te cilat nderpresin kete perrua duke llogaritur dhe prurjen qe duhet te perballojne.

**Ne kushte normale per siperfaqen e tokes qe permbyt ky perrua, kjo veper do te llogaritej per Veprat e Klasit te IV.**

**Por po te kemi parasysh pozicionin ku eshte, per nga popullsia qe rrezikohet kjo veper do te klasifikohet si e Klasit te I.**

**Nisur nga normativat e projektimit sipas VKM Nr.68 date 13.02.1989 siguria e prurjes llogaritese do te jete 3 % dhe siguria e prurjes kontrolluese do te jete 1 %.**

Projekti Zbatimi te hartohet sipas kushteve teknike te projektimit duke marre ne konsiderate te dhenat e mesiperme dhe duhet te paraqese:

- 1) Horografia ne shkallen 1:10 000 ose 1 :25 000
- 2) Planimetria e vepres, shkalle 1:10 000, 1:5 000 e 1:2 000
- 3) Profili gjatesor i kanalit shoqeruar me seksionin terthor ne çdo pikete shkalle (H 1:2000 ose 1:200)
- 4) Profilin Gjatesor
- 5) Profila terthore
- 6) Projektin per riparimin e veprave te artit egzistuese ose ndertimin e veprave te reja nese eshte e nevojshme.

**Bazuar ne VKM Nr.550,date 15.07.2020 per te marre autorizim per perdorim burimi uhor per mbrojtjen e brigjeve duhet te paraqiten :**

1.Projekti Teknik

2.Raporti Hidrologjik

2.Modelimi Hidraulik

Vlera e objektit do te jete **56 400 000 leke** me t.v.sh.

Çmimet e vleresimit do ti referohen manualit MTRT sipas VKM nr.629 date 15.07.2015.

## **II. QELLIMI I PROJEKTIT**

Rehabilitimi i Perroit te Glines.Riparimi i problematikave te krijuara ne infrastrukturen rrugore.

## **III. OBJEKTIVAT**

Objektivi kryesor është mbrojtja nga permytja e tokave bujqesore,qendrave te banuara dhe infrastruktures rrugore.

## **IV. KERKESAT**

Për keto objekte në këtë shërbim konsulenti duhet të hartojë:

### **1 – Faza e Projektimit**

Këtu do të përfshihen:

#### **1.1 Rilevimi**

Konsulenti duhet të hartojë relevimin e skemësku përfshihen:

- i) rilevimi me kuota absolute i zones të përfshire në rehabilitim
- ii) rilevimin me kuota absolute te aksit te skolieres (batimetri)

ii) profila tërthorë minimumi në çdo 70m dhe të detyrueshëm në kthesa, ndryshime seksioni, vepra arti.

#### **1.2 Projekt Zbatimi**

Konsulenti do të hartojë projektin e zbatimit për kete objekt. Rehabilitimi do të konsistojë në ruajtjen e zgjidhjeve teknike të projektit fillestar dhe ndryshime, zgjidhje të reja, plotesime me vepra arti në varësi të kushteve aktuale ku ndodhet skema.

#### **1.3 Volumet dhe Preventivi**

Konsulenti do të hartojë volumet paraprake për të gjitha kategoritë e punimeve të projektit. Volumet do të llogariten mbi bazë të vizatimeve të projektit. Çmimet njesi për të gjitha punimet do të llogariten duke patur si referencë çmimet mesatare të miratuara me manualet në fuqi.

Konsulenti duhet te paraqese tabelat e volume kryesore te punes sipas piketave.

#### **1.4 Llogaritjet përfundimtare**

Në këtë fazë, Konsulenti duhet të paraqesë një raport ku të përfshihen të gjitha llogaritjet, të cilat duhet të jenë të bazuara në Standardet Shqiptare dhe në Manualet e Çmimeve të Ndërtimit në fuqi.

## ***2 - Raportimi***

Raportet dhe dokumentet duhet të jene ne gjuhen shqipe dhe ne dy kopje origjinale. Punimet duhet te jene te kompiuterizuara me metodat bashkekohore (Word, Exel, AutoCad etj.)

Punimet duhet te dorezohen dhe ne kopje elektronike në version që janë punuar.

Konsulenti duhet të përfundoj punën brenda nje muaji .

## **3 – Marrja në dorëzim**

Marrja në dorëzim e dokumentacionit të shërbimit (raporte, projekte etj.) do të bëhet nga grup me specialistë të Bashkise Vau i Dejes.

**Në hartimin e projekteve të zbatimit do të shfrytëzohet edhe arkiva e teknike e Bashkise Vau Dejes. Për këtë qëllim, shoqeria konsulente e interesuar, përpara se të dorëzojë ofertën e saj, duhet të marrë kontakte me Bashkine Vau Dejes dhe institucionet e tjera në lidhje me disponibilitetin e materialeve që do ti nevojiten.**

**Fondi Limit për kryerjen e këtij shërbimi është 1 574 167 Lek pa TVSH**